



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:039400

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004892

KPPP.nr.238/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me seli në Ferizaj, kundër debitorit “VSH Lobby Bar Restaurant” SH.P.K., me NUI:8113853525, me seli në Prishtinë, Rruga B, Kompleksi Royal, c15/14, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin përbarimor P.nr.08/24 të datës 09.01.2024, të Përbaruesit Privat Bardh B. Tasholli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit “VSH Lobby Bar Restaurant” SH.P.K., i paraqitur ndaj Urdhri përbarimor P.nr.08/24 të datës 09.01.2024, të Përbaruesit Privat Bardh B. Tasholli.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.08/24 të datës 09.01.2024, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të Procesverbalit të Inspektoratit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me numër 00137 të datës 11.12.2023, me të cilën është urdhëruar debitori që në emër të gjobës t’ia paguaj kreditorit shumën prej 200.00 € si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, në të kundërtën në qoftë se debitorit nuk përmban mjete monetare në llogaritë e tij bankare, përbarimi të realizohet përmes regjistrimit, sekuestrimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se kreditori ka vënë shenja të dallueshme në lokal për ndalimin e pirjes së duhanit, e po ashtu i

ka paralajmëruar klientët se pirja e duhanit është e ndaluar me ligj, mirëpo ka disa klientë të cilët nuk përfillin udhëzimet. Tutje ka shtuar se sipas ligjeve në fuqi, inspektorati është dashur të gjobisë klientët dhe jo biznesin. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbarimor si dhe ta detyroj kreditorin që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Kreditori në përgjigjen në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke theksuar se i njëjti është në tërësi i pabazuar sepse Inspektorati sanitar propozimin për përmbarim e ka parashtruar si rezultat të mos pagesës së detyrimeve të debitorit në mënyrë vullnetare sipas Fletëgjobës me nr.00137 të datës 11.12.2023. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.08/24 të datës 09.01.2024, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Bardh B. Tasholli, e ka pranuar me datë 15.01.2024, e cila vërtetohet nga fletëkthesa e postës që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datë 23.01.2024.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”,* ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se: *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.08/24 të datës 09.01.2024, e ka pranuar me datë 15.01.2024, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 16.01.2024, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 22.01.2024.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 23.01.2024, e cila vërtetohet nga vula e pranimit të postës sipas numrit R 5585849 e datës 23.01.2024, ndërsa

në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me një ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.238/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.